



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.323/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci, Gyltene Sylejmani dhe Ymer Hoxha anëtarë, si dhe me pjesmarrjen e Zyrtares Ligjore Anita Peci, duke vendosur përkitazi me ankesat e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe Internews Kosova (IKS) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Deokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Klinë, për shkak të thyerjes së Heshtjes Zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen me datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 22.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohen si të bazuara ankesat e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe Internews Kosova (IKS) me seli në Prishtinë, subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Klinë i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 200.00 (dyqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi **nën kërcënim të përmbarimit**.

A r s y e t i m

Paneli i PZAP-it, në bazë të nenit 8.3 të Rregullave dhe Procedurat e PZAP-it, ka bashkuar ankesat ZL. Anr. 323/2017, ZL. Anr. 324/2017 dhe ZL. Anr. 335/2017 të datës 22.10.2017 dhe i ka trajtuar si një ankesë të evidentuar me ZL. Anr. 323/2017, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve ankimore, dhe për të tri ankesat vendosi me një vendim, për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

Me datën 22.10.2017, PZAP-i ka pranuar tri ankesa nga Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe Internews Kosova (IKS) me seli në Prishtinë. Në ZL.Anr. 323/2017 ka pretenduar se Kandidati i Lidhjes Demokratike të Kosovës për qytetin e Klinës, Ukë Kalludra në rrjetin social “facebook”, me datë 22 tetor 2017 rreth orës 4:54 ka publikuar një postim në të cilën shihet fotografia e tij, logoja dhe numri i partisë së tij dhe gjithashtu numri individual për asamble. Po ashtu në ankesat ZL.Anr. 324/2017 dhe ZL.Anr. 335/2017 parashtruesi i ankesës ka pretenduar se Kandidati i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Ali Zogjani në rrjetin social “facebook”, me datë 21 tetor 2017 rreth orës 1:23 ka shpërndar postimin në të cilin shihet fotografia e tij, logo dhe numri i tij personal, ndërsa në ora 15:35 bënë fushatë në facebookun e tij duke shpërndar foto ku bënë thirrje për ta votuar.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi të printuara lidhur me rastet në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të datës 22.10.2017, subjekti politik LDK, thekson se kandidati ynë pa dashje gjatë punës së tij në kompjuter e ka rishpërndar një postim i cili veç ka ekzistuar në rrjetin e facebookut, megjithatë kandidati në fjalë e ka korrigjuar menjëherë gabimin e tij.

Paneli, bazuar në nenin 117.2 të LZP-së, pasi që shqyrtoj ankesat vlerësoi se:

Ankesat janë të bazuara

Nga shkresat e lëndës shihet se kandidati për Kuvend Komunal në Klinë nga nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Ukë Kalludra gjatë heshtjes zgjedhore në rrjetin e tij social facebook ka bërë fushatë zgjedhore dhe ka udhëzuar që të votohet ai dhe subjekti i tij politik, ku me këtë veprim ka bërë thyerjen e heshtjes zgjedhore. Po ashtu edhe kandidati Ali Zogjani nga i njëjti subjekt politik ka bërë thyerje të heshtjes zgjedhore, pasi që në ditën e heshtjes zgjedhore ka bërë fushatë në rrjetin social facebook, duke bërë thirrje për ta votuar.

Andaj PZAP-i, duke marr parasysh këto rrethana si dhe në mbështetje të dispozitave ligjore të LZP-së, konstaton se subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), është përgjegjëse për veprimet e saja duke shkelur nenin 36 paragrafi 1 pika b) të LZP-së, që përcakton veprimet e ndaluara para procesit të votimit, ku parashihet se 24 orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet bërja fushatë në çfarëdo mënyre.

Paneli në kuptim të nenit 117.2, nenit 118.1 dhe nenit 120.1 pika c), të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

ZL. Anr.323/2017 më datën 22.10.2017.



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.